

## URBANISM WATCH

Urbanizmi i Prizrenit nën  
vëzhgim të përhershëm

17 nëntor 2015, Prizren

Komunikatë #27

### KOMUNIKATË PËR MEDIA

## Gjendja në Qendrën Historike të Prizrenit më e rëndë se që e thotë Raporti i Progresit

Gjendja në Qendrën Historike të Prizrenit gjatë vitit që po e lëmë pas nuk ka pësuar ndonjë ndryshim të ndjeshëm. Madje zhvillimet në këtë zonë janë më problematike sesa që përshkruhen në Raportin e sivjetmë të Komisionit Evropian për Kosovën.

Raporti i Komisionit Evropian ka konstatuar se ka progres në zbatimin e Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit, ndërkohë që si argument jepet vetëm ofrimi i pajisjeve dhe hapësirave për Këshillin e Trashëgimisë Kulturore, derisa në vazhdim theksohet se mjetet për këtë trup nuk janë dhënë ende.

Mirëpo zhvillimet në terren gjatë këtij viti kanë treguar një pasqyrë tjetër, sa i përket Qendrës Historike dhe Këshillit në fjalë. Raporti i Progresit askund nuk e përmend dorëheqjen e tashmë ish-kryetarit të Këshillit, apo letrën e tij, që është informatë e dorës së parë se ligji në fjalë nuk po zbatohet dhe se ka plotë defekte tjera në sistemin institucional për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, me ç'rast kulturën e pandëshkueshmërisë e konfirmojnë edhe statistikat e viteve të fundit të organeve të drejtësisë.

Përtej zyrtarëve evropianë, letra e ish-kryetarit të Këshillit është dashur që të alarmojë vet institucionet vendore. Këto të fundit, e veçmas pushteti lokal i Prizrenit, në vend se të reflektojë mbi këto zhvillime, ka ndërmarrë hapa tjerë degradues në raport me përbërjen e Këshillit, duke e zgjedhur si anëtar një person të dënuar për mashtrim në votime, ani pse ai ka qenë i katërti në listën e kandidatëve të vlerësuar. Pos kësaj, paraprakisht ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Udhëzimit Administrativ për caktimin e Komisionit ad-hoc për shqyrtimin e vlerësimitin e aplikacioneve të kandidatëve për KTK, duke e përjashtuar shoqërinë civile tërësisht nga procesi.

Megjithëkëtë, Raporti i KE-së thekson nevojën për zbatimin dhe fuqizimin e legjislacionit për të adresuar zhvillimet negative në raport me trashëgiminë kulturore.

“Incidentet e rrëtimeve të trashëgimisë kulturore kanë vazhduar. Task Forca e krijuar në vitin e kaluar që duhet të merret me ndërtimet e jashtëligjshme në Prizren, është funksionalizuar, por deri më tani nuk ka ofruar ndonjë veprim konkret. Duhet më shumë përpjekje për të hetuar shkeljet dhe për të dënuar kryesit. Nevojiten rezultate konkrete në luftimin e ndërtimeve ilegale, rrëtimeve dhe zhvillimeve të dëmshme për të demonstruar përkushtimin e Qeverisë për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore”, thuhet në Raport.

EC Ma Ndryshe konsideron se institucionet që kanë përgjegjësi ligjore e kushtetuese për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore duhet të ndryshojnë qasjen e deritanishme dhe të vihen në mbrojtje të sigurtë të Qendrës së Prizrenit, me qëllim që me një menaxhimin të mirëfilltë të kësaj zone, e njëjta të vihet në

funksion të zhvillimit të përgjithshëm kulturor, shoqëror dhe ekonomik të qytetit, por dhe komunave të rajonit.

*Me nderime,*

Valon Xhabali, Koordinator i Projektit

OJQ EC Ma Ndryshe

Rr. Saraçët, Nr. 5 – Prizren &

Bulevardi Nëna Terezë 30B H-I-.5, 10000 Prishtinë

[www.ecmandryshe.org](http://www.ecmandryshe.org) & [info@ecmandryshe.org](mailto:info@ecmandryshe.org)

+381 38 224 967 & +381 29 222 771

## URBANISM WATCH

Urbanizmi i Prizrenit nën

vëzhgim të përhershëm

përkrahjet financiarisht nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur



Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur  
Kosovo Foundation for Open Society  
Kosovska Fondacija za Otvoreno Društvo